

Rrjetet e Ekselencës, shkëmbimi i praktikave më të mira në Evropën Juglindore.

Tiranë, 19 janar 2015



Në kuadër të aktiviteteve të kalendarit të Presidencës Shqiptarë të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Jug-Lindore (SEECF), në datë 19 janar 2015, u zhvillua në Tiranë Konferenca Rajonale: “Mbi Rrjetet e Ekselencës në Evropën Jug-Lindore”, organizuar nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme.

Në Konferencë morën pjesë ekspertë të Ministrive të Arsimit dhe Shkencës të vendeve të SEECF-së, të cilët diskutuan, shkëmbyen informacione, përvoja dhe ekspertiza rreth temës së konferencës.

Konferencën e përshëndetën, z. Gjergj Murra, Koordinator i Kombëtar i Shqipërisë SEECF/RCC, z. Gazmend Turdiu, Zv/Sekretar i Përgjithshëm i RCC.

Gjatë fjalës së tij përshëndetëse, z. Murra theksoi rëndësinë e SEECF-së dhe vuri në dukje rolin e presidencës tonë në këtë nisim si një ndërmarrje e rëndësishme politiko-diplomatike, me synimin që Tirana të bëhet: “kryeqyteti i aktiviteteve Rajonale”, pasqyrë e prioriteteve të politikës sonë të jashtme, mbështetur në fqinjësinë e mirë dhe në rritjen e impaktit dhe imazhit të Shqipërisë.

Pjesëmarrësit falenderuan Presidencën Shqiptare dhe Sekretariatën e RCC-së, për mundësimin e shkëmbimit të eksperiencave në këtë fushë.